



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 29.11.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.11.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Ledimed Shpk" për aktivitetin: < "Furnizim me material shpenzues për RO Kabinetin" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-8545-121 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "**Ledi med SHPK**" e datës 27.11.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material shpenzues për RO Kabinetin" me Nr.616 18 8545 121 kundër *Njoftimit të Vendimit për dhënje të kontratës* te AK –së, të datës 22.10.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet *Njoftimi i Vendimit për dhënje të kontratës* i publikuar me datë: 22.11.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Furnizim me material shpenzues për RO Kabinetin" me datë 22.11.2018 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material shpenzues për RO Kabinetin", me numër të prokurimit 616 18 8545 121.

Autoriteti Kontraktues, me datë 29.11.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:


1. Pretendimi i parashtruesit të kërkesës se i tenderuesi i propozuar për dhënje të kontratës nuk ka dorëzuar çertifikata apo dëshmi për të gjitha llojet e mallrave është i

pa qendrueshëm për arsye se tenderuesi i propozuar ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara, respektivisht ka dorëzuar Deklaratë se të gjitha mallrat do ti furnizoj në harmoni me kërkesat e Aneksit 1 Specifikimet teknike të detyrueshme dhe një çertifikatë të prodhuesit, e cila vlen për të gjitha llojet e filmave për rentgen e që d.t.t.h. se vlen edhe për të gjitha llojet e kërkuara në Aneskin 1 dhe në përshkrimin e çmimit. Duhet t'ia përkujtojmë pretenduesit se edhe çertifikata e sjell nga ai është me përmbajtje të njejtë, respektivisht çertifikatë me të cilën dëshmohet prodhimi i të gjitha llojeve të filmave për rentgen. Nga kjo rrjedh se me dëshmi të njejtë është propozuar për dhënje të kontratës tenderuesi me çmimin më të ulët duke respektuar kriterin për dhënje të kontratës.

Bazuar në sqarimet paraprake u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit